



Republika e Shqiperise
 Universiteti i Vlores "Ismail Qemali"
 Departamenti i Shkencave Kompjuterike
 dhe Inxhinjerise Elektrike

Lenda: BrainGain Kthime Returns

1. Kur u larguat nga Shqipria, u larguat me mendimin pr t mos u kthyer m apo thjesht pr t vazhduar studimet?

U largova ne Shtator 1993. Nuk ishte e qarte per mua se cfare do te beja me tej, po ishte e sigurt qe Shqiperia ne ate kohe nuk me ofronte asnje gje. U largova sepse nuk kisha te ardhme ketu.

2. Ju keni fituar mim n Olimpiadn Kombtare t Fziks ndrsa studimet i keni mbaruar n degn e Matematiks. Pse ky ndryshim?

Ne fakt studimet i kam mbaruar ne degen e Matematikes se Aplikuar, ose ndryshe Shkenca Kompjuterike ndersa studimet pasuniversitare i kam vazhduar ne Gjeometri Kompjutacionale e cila eshte dege e po kesaj fushe. Kam mare pjese edhe ne olimpiadat e matematikes kur isha ne shkolle te mesme "Halim Xhelo" ne Vlore, po ate vit nuk mu dha mundesia qe te konkurroja ne me shume se nje olimpiade, keshtu qe konkurrova ne Fizike. Sidoqofte, edhe ne shkolle te mesme interesat e mia akademike kane qene me afer matematikes sesa fizikes.

3. A ishte fillimi i Programit Brain Gain nj ndr faktort q jua lehtsoi vendim-marrjen pr tu kthyer?

Jo! Per Braingain mesova shume me vone, dhe mendova qe ishte nje vleresim qe me behej me shume ne aspektin moral sesa ne ate monetar, po nuk ishte as faktor per tu kthyer as faktor per te vazhduar te qendroja ne kete institucion. Te dy keta faktore kane me shume te bejne me drejtimin e ri qe mori universiteti pas ardhjes se Prof. Shaskes ne postin e Rektorit.

4. far mbani mend nga koha kur u larguat?

Rremuje. Korrupsion. Padrejtesi. Asnje gje pozitive. Nje vend pa shprese dhe pa te ardhme. Nje shoqeri ne degradim intelektual dhe moral.

5. A keni hasur pengesa n ingranimin tuaj profesional dhe a ju kan br kto pengesa t mendoni pr nj kthim mbrapa?

Po. Nderhyrjen e politikes te te gjitha ngjyrave dhe interesave te ngushta personale per te penguar ate qe po perpiqemi te realizojme ketu ne Universitetin e Vlores.

Mungesa e ambienteve. Mosaprovimi i programeve akademike nga ministria e arsimit dhe shkences (MASH).

Politika krejtesisht e gabuar dhe absurde e masivizimit te arsimit te larte. Pranimi i detyruar i maturanteve qe nuk plotesojne kriteret akademike ne Universitetin e Vlores. Shkelja e ligjit te arsimit te larte nga MASH per ti mohuar Universitetit te Vlores edhe ate pak autonomi qe na lejon ajo kornize ligjore e aprovuar nga parlamenti shqiptar.

Mungesa te bazes materiale, dhe kolegeve me orientim nga kerkimi shkencor, burokracite qe mbushin nje pjese te mire te dites sime si pergjegjes departamenti ne vend qe tia dedikoj kete kohe shkences.

Kjo me ben ndonjehere te mendohem per nje kthim mbrapa, mirepo ne jeten time nuk jam dorezuar asnjehere aq lehte perpara veshtiresive.

6. A e shikoni veten tuaj t ingranuar plotsisht n jetn Shqiptare?

Jo, aspak. Nuk i duroj dot padrejtesite qe perjetoj perdite. Qe nga polici i rruges qe me ndalon pa shkak si nje bandit me uniforme per te me marre rryshfet, e deri tek te pa-aftet qe popullojne te gjitha hallkat e arsimit te larte dhe qe ushtrojne presion per te marre ate qe nuk e meritojne.

Te pa-aftet dhe mediokrit jane shushunjat e shoqerise, dhe pedagoget i bejne shoqerise nje sherbim shume te vyer duke mos i lene ata te majmen me tej ne dem te saj. Eshte fatkeqsi kur shikon sesa pak vleresohet kjo gje.

Pedagoget ne Shqiperi jane shtresa me pak e mbrojtur dhe me pak e vleresuar. Ekziston per shembull statusi i nepunesit civil, po nuk eksiston nje mbrojtje e ngjajshme ligjore per pedagoget, te cilet perplasen me lloj lloj njerezish dhe presionesh perdite, qe nga "vipat" e deri tek rrugacet ordinere qe futen ne auditoret tona si aksident i politikese se masivizimit te arsimit te larte.

Jam tanime pjese e ketij sistemi jete dhe pune, mirepo punoj brenda tij me nje sistem personal vlerash qe nuk e perkrah dhe madje e lufton shumica. Kjo e ben te veshtire ingranimin tim ne jeten ne Shqiperi.

7. Programi Brain Gain sipas jush sukses, jo ai q pritej t ishte apo dika krejt ndryshe?

Nuk ka patur ndonje rol per mua personalisht. Ishte fillimisht nje vleresim moral, por me vone e kam refuzuar programin Brain Gain per aresye te mosperputhjes se politikave te tjera qeveritare me misionin te cilin presupozon qe mbeshtet ky program.

8. E ardhmja. Si e mendoni at pr veten, pr institucionin ku ju punoni dhe pr Shqiprin.

Per veten une do te vazhdoj te bej ate qe kam bere gjithmone, te punoj dhe luftoj per ate qe ndergjegjija ime e konsideron te drejte. Ndoshta do te jem ne

Shqiperi ndoshta gjetke, kjo varet nga faktore jashte kontrollit tim.

Do te vazhdoj te punoj qe universiteti i Vlores te behet shembull per te gjithë universitetet Shqiptare. Ky universitet tanime funksionon si cdo universitet prestigjuz ne bote, ku mesimi fillon i rregullt qe ditën e pare te shkolles, ku studentet testohen rigorozosht gjate vitit akademik dhe jane te lire te zgjedhin lendet e tyre disa muaj perpara fillimit te semestrit. I vetmi ndryshim qendron tek niveli i ulet shkencor i pedagoqeve dhe i studenteve.

Per sa i perket te ardhmes se ketij institucioni, ajo do te varet nga cilesia e produktit qe nxjerr jo nga sasia. Ky do te jete objektivi drejt te cilit do te punoj bashke me koleget e mi. Perndryshe ky institucion nuk ka te ardhme per te cilen ia vlen te punosh.

Keto objektiva qe une dhe koleget e mi i kemi vene vetes, do te realizohen me shpejt neqoftese kemi dhe mbeshtetjen e politikes dhe te shoqerise. Do te jete shume e veshtire qe universitetet publike te behen konkurruese ne botën akademike pa patur nje autonomi te gjere akademike dhe financiare.

Neqoftese kjo mbeshtetje do te mungoje atere do te jete shume e veshtire per ti realizuar keto objektiva, dhe neqoftese veshtiresia kthehet ne pamundesi une do te largohem perfundimisht nga Shqiperia me keqardhjen qe nuk mu dha mundesia te beja dicka pozitive per vendin tim, dhe ky brez i ri sot eshte po aq i pashprese dhe pa te ardhme ketu, sic isha dhe une ne Shtator 1993.

Ervin Ruci, MSC.
Pergjegjes Departamenti

Vlore, 11 Dhjetor 2009